



Duket se nuk do të jete edhe aq i thjeshtë rinovimi i Xhani De Biazit me Shqiperine. Pas kthimit nga dy ndeshjet e humbura ne Slloveni dhe Islande, kontrata e italianit me kuqezinjte ende nuk eshte firmosur. Armand Duka ka deklaruar se De Biazi e ka deren te hapur ndersa vete trajneri ka thene se ja ka lene ne dore presidentit. As njeri dhe as tjetri nuk kane hedhur hapin e pare. Duket se kjo periudhe do te jete nje faze ku te dy do te testojne nervat perpara se te vendosin per tu ulur dhe vendosur perfundimisht per rinovimin. Tifozet kuqezi bejne presion qe De Biazi te mos largohet por ne fund do te jete presidenti i FSHF-se ai qe do te vendosi.